

LENKA J. BUDILOVÁ
MAREK JAKOUBEK¹

BALLKANI DHE ANTROPOLOGJIA SOCIAL-KULTURORE- LINJA KRYESORE E MARRËDHËNIEVE RECIPROKE NGA FILLIMI I SHEKULLIT XX DERI NË VITET '70-TË²

Abstrakt

Ky tekst ofron vlerësimin e hulumtimeve antropologjike, koncepteve dhe teorive që kanë lidhje me territorin gjeopolitik të Ballkanit, dhe kjo për periudhën nga fillimi i shekullit të 20-të deri në vitet '70. Përmbledh interesin e antropologjisë anglo-saksone sociale dhe kulturore për këtë pjesë të Europës dhe e vendos atë në kontekstin e diskutimeve antropologjike të Europës dhe shoqërive komplekse. Në të njëjtën kohë përqendrohet tek konteksti social dhe politik i këtyre hulumtimeve në terren. Një kujdes i veçantë i jepet edhe bashkëpunimit midis antropologjisë anglo-saksone dhe përfaqësuesve të traditave lokale kërkuese (etnologjia, etnografia, folkloristika), po ashtu edhe dallimeve midis këtyre traditave shkencore.

Fjalë kyçe: Antropologjia, Ballkani, hulumtim në terren, antropologjia e Europës, antropologjia e shoqërive komplekse

Abstract

The text offers a summary and assessment of anthropological research, concepts, and theories that relate to the space of the Balkans. The

¹ Autorët punojnë në Departamentin e Etnologjisë në Charles University, Pragë.

² Teksti është një version i modifikuar dhe i zgjeruar i: Budilova 2018. Kjo punë shkencore është mbështetur nga Fondi European për Zhvillim Rajonal –Projekti: "Kreativiteti dhe përshtatja si kushte të Suksesit të Europës në një botë të ndërlidhur" (Nr. CZ.02.1.01/0.0/0.0/16_019/0000734).

authors focus on the international intellectual community, which draws from methodological and theoretical stances of social and cultural anthropology and creates a specific academic tradition, the results of which are published mostly in English. Attention is also paid to forms of cooperation between the local scholarly traditions (ethnology, ethnography, and folkloristics) and social and cultural anthropology, but also to differences between these traditions. The authors attempt to place the results of field research and theoretical concepts developed in connection with this geographical space into the context of anthropological research of Western societies, primarily those of Europe.

Keywords: Anthropology, Balkans, Fieldwork, Anthropology of Europe, Anthropology of complex societies

Ky tekst ofron vlerësimin e kërkimeve, koncepteve dhe teorive, të cilat kanë lidhje me kërkimet antropologjike në Ballkan, deri në vitin 1945. Interesi i tij përqendrohet tek shoqëria ndërkombëtare intelektuale, e cila rrjedh nga bazat metodologjike dhe teorike të antropologjisë sociale dhe kulturore britaniko-amerikane. Si aspekte specifike të kësaj disipline mund të vlerësohen: 1) hulumtimi në terren për një kohë të gjatë, i realizuar në gjuhën vendase, ku instrumenti bazë metodologjik është vëzhgimi i pjesëmarrësve (*participant observation*); 2) përdorimi i qartë i teorisë. Antropologët nuk kërkojnë të përshkruajnë fakte individuale, por të nxjerrin përfundime të përgjithshme, me të cilat do të kontribuojnë në zhvillimin teorik të antropologjisë si një shkencë e shoqërive njerëzore. Ky diskutim krijon një traditë akademike specifike, rezultatet e të cilit, në përgjithësi, janë të publikuara në gjuhën angleze (krahaso Cole 1977: 351). Hulumtimet, konceptet teorike dhe botimet e autorëve hulumtues vendas në këtë tekst shfaqen vetëm atëherë kur, në një mënyrë më të theksuar, janë futur në dialog pikërisht me traditën anglofone të përmendur më lart, domethënë, ne nuk merremi me qëllim me traditën (edhe pse tepër të veçantë) gjermane.

Kërkimet në terren dhe konceptet teorike të zhvilluara në lidhje me këtë ambient gjeopolitik do të mundohemi t'i vendosim në kontekst me kërkimet antropologjike të shoqërive perëndimore komplekse, sidomos të Europës.

Për sa i përket vetë territorit të Ballkanit, edhe pse përfundimi konkret i këtij termi mund të ketë shumë kuptime, gjithmonë kemi të bëjmë me një kompleks të qartë të kriterëve gjeografike, politike dhe historike. Me fjalët e antropologes britanike Sarah Green, vetëm pak autorë kanë të njëjtin mendim se çfarë është Ballkani në vetvete (Green 2005: 130). Ballkani në ligjërimin antropologjik (edhe jashtë tij) është një term i definuar jo qartë, që shfrytëzon në mënyrë primare kriterë gjeografike, të cilat kanë edhe një përmbajtje politike (kjo gjë ka ndodhur edhe në lidhje me luftën në Jugosllavi gjatë viteve '90 të shekullit të 20-të) (Ballinger 1999: 8). Antropologja Maria Todorova e vlerëson termin Ballkan si *tregues*, i cili është ndarë nga *i treguari* i tij fillestar: termi gjeografik gradualisht ka thithur kuptim social dhe kulturor, të cilat kanë ndryshuar hapësirën e termit fillestar jashtë kufijve të kuptimit të tij të menjëhershëm dhe konkret (Todorova 1997: 21).

Ashtu siç janë dakord edhe autorë të tjerë (Hall dhe Danta 1996, 3–4; Stoianovich 1992: 1–3; Vezenkov 2017, 141–143) nuk është i mundur përkufizimi i Ballkanit, i bazuar vetëm në një faktor ose aspekt. Prandaj, edhe në këtë kontekst, do të punojmë me termin Ballkan, i cili pjesërisht bazohet tek përkufizimi gjeografik (Gadishulli Ballkanik), pjesërisht në zhvillimin e përbashkët historik (kryesisht vendet që ndajnë trashëgiminë osmane) dhe pjesërisht në lidhjet politiko-kulturore (vende - me përjashtim të Greqisë – të ish Bllokut Lindor). Gjithashtu, Ballkanin, do ta kuptojmë si territorin e sotëm të Rumanisë, Bullgarisë, Greqisë, ish-Jugosllavisë dhe Shqipërisë.

Antropologjia anglo-saksone shoqërore dhe kulturore dhe (mos) interesi i saj në Europë

Antropologjia shoqërore dhe kulturore anglo-saksone ka filluar, që nga fillimi i zhvillimit të saj, të profilizohet si një disiplinë që përqendrohet kryesisht tek shoqëritë jo-perëndimore, ekzotike. Për këtë lloj bashkësie, e cila nuk kishte asnjë traditë të shkruar (dhe, shpesh, jo një gjuhë të kodifikuar në fillim) dhe që ishte e vogël në numër (small-scale societies), u zhvillua metoda e hulumtimit në terren. Kjo metodë konsistonte në pjesëmarrjen afatgjatë të antropologut në aktivitetet e përditshme të

anëtarëve të shoqërisë së anketuar për t'i dhënë mundësi atij të kuptojë pikëpamjen e tyre për botën. Trashëgimia e ankorimit kolonial të antropologjisë anglo-saksone, për një kohë të gjatë, kishte sjellë në qendër të vëmendjes së interesit antropologjik vendet që gjendeshin nën sundimin kolonial, pra komunitetet ekzotike, shoqëri jo-europiane (të paktën të perceptuara si të tilla) të largëta, të dallueshme dhe ekzotike. Përkundrazi, shoqëritë komplekse, moderne, perëndimore kanë qenë prej kohësh jashtë vëmendjes së kësaj disipline. Kjo filloi të ndryshojë gradualisht pas Luftës së Dytë Botërore (ndër të tjera) në lidhje me shembjen e perandorisë koloniale britanike, kur studimet antropologjike në terren filluan të realizohen gjithnjë e më shumë edhe në Europë (Kuper 1996: 176–179).

Në përputhje me këtë përqendrim në bashkësi me natyrën gjoja të thjeshtë, të vogël dhe "ekzotike", nocioni antropologjik i tjetërsimit brenda shoqërive komplekse të Europës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës ishte më i afërti me komunitetet rurale, që ishin të parët që u bënë objekt i hulumtimeve antropologjike brenda zonës kulturore euro-amerikane. Studimet e para për komunitetet fshatare, qoftë në Amerikën e Veriut apo në Europë, janë shfaqur që nga vitet 1920. Hulumtimi i antropologut amerikan Robert Redfield me fshatarë meksikanë nga vitet 1920 dhe 1930 ka ngjallur interes për shoqëritë komplekse në anën amerikane të Atlantikut. Bazuar tek të dhënat e tij të terrenit, por edhe duke e krahasuar atë me hulumtime të tjera të komunitetit fshatar në të gjithë botën, Redfield u përpoq të përcaktojë "komunitetet fshatare" (*peasant societies*) si një lloj shoqërie që bëhet interesi i antropologut krahas shoqërive "primitive". Sipas Redfield-it, "komunitetet fshatare" karakterizohen nga fakti se ato nuk janë "kultura" autonome lokale, por bashkësi që janë pjesë e një grupi më të gjerë të shteteve-komb moderne. Marrëdhënia midis nivelit lokal të fshatit dhe strukturës më të gjerë shoqërore të shtetit modern adresohet nga Redfield-i duke prezantuar konceptet e "traditave të vogla dhe të mëdha", që korrespondojnë me secilën nga këto nivele, por nuk ekzistojnë në mënyrë të pavarur nga njëra-tjetra, por (vetëm) të ndërlidhura me njëra-tjetrën (Redfield 1956: 40–59).

Shumë pak kërkime antropologjike janë kryer në Europë para Luftës së Dytë Botërore. Një nga të parët u bë në vitet 1932–1934 nga antropologët amerikanë Conrad Arensberg dhe Solon Kimball në County Clare, në

perëndim të Irlandës. Tekstet e tyre (Arensberg 1937; Arensberg dhe Kimball 1940) konsiderohen të jenë një nga rastet e para të aplikimit të metodave të fushës antropologjike në tokën europiane. Ata u përqendruan kryesisht në komunitetet e fshatit dhe analizuan tema të tilla, si: martesë, familja ose transferimi i pronës familjare. Tek studime të ngjashme pionierësh që, si etnografia e lartpërmendur e Irlandës, kontribuan në zhvillimin e mëvonshëm të “community studies” në Europë, përfshihen edhe kërkimet nga antropologu i Oksfordit Julian Pitt-Rivers, i cili kreu kërkime në terren në Grazalema, në një fshat andaluzian gjatë viteve 1949-1952 (Pitt-Rivers 1954). Monografia e tij antropologjike është bërë klasike dhe konsiderohet një pikë referimi e zhvillimit të antropologjisë së Europës (Goddard, Llobera dhe Shore 1994: 5). Nëpërmjet teksteve të Pitt-Rivers - falë mentorit të tij, një antropologu nga Oksfordi i lindur në Pragë, Franz Baerman Steiner - ligjërimi i antropologjisë shoqërore britanike është ndikuar nga tradita etnologjike dhe sociologjike gjermane, megjithëse referencat e qarta për traditën gjermane janë hequr (me dëshirën e Evans-Pritchard-it), sepse linja zyrtare e antropologjisë shoqërore britanike nxori prejardhjen e saj intelektuale nga sociologët francezë dhe nga puna e A.R. Radcliffe-Brown (Pina-Cabral 2010: 69).

Në këtë kontekst mund të përfshijmë edhe hulumtimet e para antropologjike në Ballkan, qoftë ato studime të viteve 1930 në lidhje me “zadrugën” e sllavëve të jugut nga antropologu amerikan Philip Mosely (Byrnes 1976), ose hulumtimi i sociologut amerikan Irwin Sanders në Bullgari në të njëjtën periudhë (Sanders 1949). Ballkani u bë një zonë tërheqëse për antropologjinë, sepse në shumë aspekte ajo përmbushi nocionin e saj të tjetërsimit brenda botës perëndimore: ishte një rajon marginalisht politik dhe ekonomik, i karakterizuar nga një diversitet i madh etnik, një mbizotërim i popullatës fshatare dhe mbas Luftës së Dytë Botërore mbizotëronin institucione socialiste me një ekonomi të planifikuar, e cila e dalloi atë nga perëndimi kapitalist (Halpern dhe Kideckel 1983: 379).

Udhëtime dhe etnografia e parë amatore e Ballkanit

Studimet antropologjike moderne kishin pararendësit e tyre në formën e udhëtimeve etnografike të orientuara, të cilat shpesh lidheshin me një interes për ekzotiken dhe të veçantën. Që nga fundi i shekullit të 18-të,

destinacioni i këtyre udhëtimeve është bërë, mbi të gjitha, pjesa e Europës që ishte pjesë e Perandorisë Osmane, e cila u cilësua si "Turqia Europiane". Një pjesë e edukimit të antropologëve britanikë ka qenë prej kohësh një "grand tour" (Cole 1977: 350), i cili shpesh drejtonte në pjesët jugore të Europës, të cilat shiheshin si rajone ekzotike dhe admiroheshin si trashëgimtare të supozuara të traditës së madhe antike. Përveç trashëgimisë antike të rajonit, ky prodhim letrar vuri në dukje edhe popullsi lokale sllave dhe jo-sllave, dhe shpesh theksoi diversitetin dhe ngjashmërinë e kulturave lokale në raport me Europën Perëndimore (krahaso Todorova 1997: 62–115). Shumë nga këto vepra sjellin njohuri interesante etnografike për Gadishullin Ballkanik në atë kohë, megjithëse cilësia dhe besueshmëria e teksteve nuk janë në të njëjtin nivel.

Disa udhëtime të tilla për në "Turqinë Europiane" u ndërmorën në vitet 1861-1864, për shembull, nga turistet britanike Georgen Mackenzie dhe Adeline Irby (1971 [1966]), të cilat u përqendruan kryesisht në popullatën e krishterë dhe sllavfolëse të Perandorisë Osmane të atëhershme. Ato i kushtuan vëmendje një numri aspektesh që përfshihen në fushën e etnografisë, nga feja, te pozita e grave, deri në përshkrimin e tipareve të karakterit "tipik" të grupeve etnike individuale në Ballkan. Nuk është pa interes që impulsi për të shkruar shënime nga udhëtimet e tyre erdhi nga takimet me rilindasit çekë në Pragë dhe Vjenë (ato kanë përmendur në mënyrë të veçantë F. Palackýn), të cilët shprehën interes për të marrë informacion më të detajuar për vëllezërit e tyre sllavë në Europën Juglindore (Mackenzie dhe Irby 1971: xiv).

Puna e shkrimtares britanike Mary Edith Durham, e cila udhëtoi nëpër Dalmaci, Mal të Zi dhe Shqipëri në fillim të shekullit të 20-të, është gjithashtu një dëshmi e rëndësishme për Ballkanin në fillim të këtij shekulli. Vendi i fundit u bë interesi i saj i përhershëm: M. Durham u kthye vazhdimisht në Shqipëri dhe kaloi disa vjet të jetës së saj atje. M. Durham ka botuar një numër tekstesh në revistat *Man* dhe *Journal of the Royal Anthropological Institute*, duke u përqendruar kryesisht në fenomene "ekzotike", siç janë: gjakmarrja, *kuvade* apo martesë me rrëmbim në Shqipëri. Materiali etnografik më gjithëpërfshirës gjendet në monografitë e saj *Some Tribal Origins, Laws and Customs of the Balkans* (1928). Në mënyrë të ngjashme, gazetarja dhe shkrimtarja irlandeze Rebecca West, duke u bazuar tek

udhëtimet e saj nëpër Jugosllavi gjatë viteve 1936–1938, botoi monografinë e saj të udhëtimeve dedikuar historisë, etnografisë dhe kulturës së këtij vendi ballkanik (West 1941).

Në kategorinë e interesit para antropologjik për Ballkanin (megjithëse jo amator), mund të përfshijmë edhe veprën e njohur të historianëve britanikë Alan Waters dhe Maurice Thompson (1914) mbi popullsinë vllahe të Ballkanit. Wace dhe Thompson ishin historianë, arkeologë dhe gjuhëtarë të njohur në kohën kur filluan të merreshin me vllahët transhumanë në territorin e ndarë më pas midis Greqisë dhe Perandorisë Osmane. Më 1910, pas një marrëveshjeje paraprake, ata u bashkuan me një grup vllahësh, të cilët sapo ishin zhvendosur nga stacionet e dimrit në tokat e ulëta të Thesalisë dhe u nisën për në pelegrinazhin e tyre vjetor në fshatrat malorë në malet e Pindit, të cilat i konsideronin si shtëpinë e tyre. Wace dhe Thompson (1914) kapën historinë e këtij grupi, analizuan gjuhën e tij, por, gjithashtu, përshkruan organizimin shoqëror, strategjitë ekonomike, kulturën materiale (veshje, arkitekturë, monumente sakrale) dhe zakonet që lidhen me martesën. Metoda e tyre, e cila është jashtëzakonisht e ngjashme me mënyrën antropologjike të punës në terren (pjesëmarrja afatgjatë në aktivitetet ditore të grupit të monitoruar), çoi në një rezultat që ende konsiderohet si një nga etnografitë më të mira të kësaj pakice specifike joshtetërore në Ballkan.

Interesi antropologjik për Ballkanin: gjakmarrja, kuvade, zadruga

Përveç udhëtimeve të orientuara etnografikisht, janë realizuar disa hulumtime antropologjike shumë me vlerë në Ballkan para Luftës së Dytë Botërore. Kjo u bë e mundur nga hapja relative dhe lëvizja nëpër kufij në këtë kohë (në këtë drejtim, situata ndryshon ndjeshëm nga zhvillimi i pasluftës). Shumë hulumtime antropologjike në Ballkan në këtë periudhë u përqendruan në fenomene "ekzotike", si gjakmarrja ose kuvare (Coon 1950; Hasluck 1933; 1939; Obrębski 1934), të cilat, në mënyrë paradoksale, nuk ndryshonin shumë nga traditat e lartpërmendura para-shkencore të udhëtimit. Një zonë tjetër e studiuar gjerësisht ishte një lloj specifik i familjes së shtrirë në Ballkan, referuar nga termi lokal “zadruga”. Shumica e studiuesve u përqendruan në përshkrimin e kulturave specifike lokale,

kryesisht për komunitetet e fshatit, të cilat konsideroheshin se ishin përfaqësues tipikë të "shoqërisë tradicionale", falë të cilave do të ishte e mundur të rindërtoheshin karakteristikat e secilës "kulturë kombëtare".

Ashtu siç përmendin Halperni me Kideckelin (Halpern dhe Kideckel 1983: 380), është interesante se një nga vendet më të hulumtuara në këtë periudhë ishte Shqipëria, një vend që u bë gati i paarritshëm për kërkime antropologjike pas Luftës së Dytë Botërore. Për shembull, studiuesja skoceze Margaret Hasluck kaloi rreth 15 vjet në Shqipëri në vitet 1920 dhe 1930, gjatë së cilës ajo zotëroi shqipen dhe botoi gramatikën e parë shqip-anglisht. Për më tepër, ajo iu përkushtua intensivisht koleksionimit të materialit folklorik dhe etnografik, i cili përshkroi karakterin e shoqërisë shqiptare dhe traditat e saj në periudhën e paraluftës. Ajo i kushtoi vëmendje aspekteve të ndryshme të shoqërisë fisnore shqiptare, të tilla, si gjakmarrja ose pagesa për nusen (Hasluck 1933) dhe kontribuoi me një numër tekstesh të vogla në revistat profesionale. Një monografi sistematike që përmbledh materialin e saj etnografik u botua vetëm pas vdekjes (Hasluck 1954). Një kontribut tjetër ishte studimi i antropologut amerikan Carleton S. Coon me ekipin e tij, midis viteve 1929 dhe 1930, i cili kreu anketime antropometrike në një kampionim të më shumë se 1.000 personave nga komuniteti fisnor i gegëve në veri të Shqipërisë. Edhe pse studimi i Coon-it është kryesisht në fushën e antropologjisë biologjike, ai i kushtoi pothuajse gjysmën e tekstit të tij kontekstit kulturor, shoqëror dhe historik të popullatës në shqyrtim. Përveç karakteristikave të (kryesisht) jetesës baritore të fiseve malore, traditës së gjakmarrjes dhe analizës së rregullave të përzgjedhjes së partnerit në martesë, ai vë në dukje edhe fenomenin e virgjërshave të betuara (*sworn virgins*) - gra që nuk hyjnë në martesë dhe nga ana sociale kthehen në burra (Coon 1950).

Një nga gjurmët më domethënëse në studimin antropologjik të Ballkanit u la nga historiani dhe antropologu amerikan Philip Mosely, i cili kreu kërkime komparative familjare dhe shtëpiake në Ballkan në gjysmën e dytë të viteve '30. Fillimisht ai studioi rusisht dhe ishte i interesuar për politikën e jashtme sovjetike, e cila e bëri atë të studionte në Moskë. Ai më vonë mori një bursë, fillimisht e destinuar për studimin e politikës së jashtme ruse, por me kusht që ai të hulumtojë popullsinë aktuale rurale të Europës Juglindore. Kështu që Mosel shkoi së pari në Londër, ku u

regjistrua në një seminar me B. Malinowskin dhe, më pas, në Ballkan (Mead 1976: xviii). Këtu ai studioi “zadrugat”, një formë specifike e një familjeje të zgjeruar që jetojnë së bashku. Në hapësirën publike në SHBA-së ai ka qenë gjithmonë i njohur si përkrahës i antropologjisë së aplikuar, një ekspert për marrëdhëniet e huaja (veçanërisht SHBA-Bashkimi Sovjetik), autor i analizave të metodave të negociatave sovjetike, ose si një pjesëmarrës aktiv në negociatat midis fuqive në fund të Luftës së Dytë Botërore (Mead 1976: xviii). Tekstet e tij “ballkanike” nuk gëzuan një popullaritet kaq të gjerë dhe u botuan përfundimisht pas vdekjes së tij. Është kryesisht një përmbledhje tekstesh kushtuar kryesisht problemeve të fiseve sllave të jugut (Mosely 1976a, 1976b, 1976c), e cila u botua nga P. Mosely në revista, dhe u botua pas vdekjes për nder të tij, falë kujdesit të nxënësve të tij (Byrnes 1976).

Mosely e kuptoi “zadrugën” si një familje të zgjeruar të familjarëve (në anglisht: “*communal joint-family*”), të përbërë nga dy ose më shumë familje nukleare aleate, të cilat vepronin si një bashkësi në pronësi të përbashkët për ndarjen e pasurive dhe burimeve të përbashkëta (Mosely 1976a: 19; Mosely 1976c: 59). Ai theksoi se përcaktimi i një “zadrugë” si një tip tjetër nga ana kualitative e familjes sesa një familje nukleare është mendim tendencioz, sepse vetë aktorët nuk e kuptuan këtë në këtë mënyrë. Në të njëjtën kohë, ai argumenton se “zadrugat”, si dhe familjet nukleare, mund të kuptohen si faza të caktuara të ciklit të zhvillimit të familjes (Mosely 1976a). Ai përshkroi vendet e Ballkanit që shqyrtoi në periudhën e paraluftës, si shoqëritë që pësuan ndryshime rrënjësore të lidhura me modernizimin, urbanizimin, arsimimin dhe ndryshimet legislative për të siguruar të drejtat e trashëgimisë së grave. Kështu që ai ishte larg nga kërkimi i “modeleve tradicionale” të shoqërisë fshatare në fshatra dhe paraqitjen e “zadrugës” si një aranzhim i lashtë dhe i pandryshueshëm i familjes në Ballkan. Në tekstet e tij, përkundrazi, ai analizoi se si “zadrugat” funksiononin në një kohë kur ai kishte mundësinë t’i vëzhgonte ato menjëherë (Mosely 1976b). Ai u përpoq ta hiqte këtë formë të veçantë të shtëpisë së familjes sllave të jugut nga idetë thelbësore, që i dhanë asaj një bazë “etnike” ose “raciale” dhe përfundon se veçoritë themelore të saj nuk ndryshojnë në varësi të etnicitetit të popullatës (Mosely 1976a; Mosely 1976c: 65). Me anë të një analize të kujdesshme të të dhënave të tij në terren nga zona e ish-Jugosllavisë, por edhe nga Bullgaria dhe Shqipëria, si dhe nga burime të tjera të besueshme, ai dalloj tri fusha të

shfaqjes së fiseve, të karakterizuara nga specifika të caktuara dhe shkallë të ndryshme të ruajtjes ose zhdukjes së këtij institucioni. Përveç Sllovenisë, Rumanisë dhe rajonit Mesdhe të Dalmacisë, Greqisë dhe Bullgarisë Lindore, këto zona përfshinin pothuajse të gjithë Europën Juglindore (Mosly 1976c). Ai i kushtoi vëmendje të veçantë një problemi të veçantë (Varçiq) në Sllavoninë kroate, tek e cila ai tregoi funksionimin, bashkëpunimin ekonomik, si dhe mënyrat e ndarjes së pasurisë familjare (Mosely 1976b).

Mosely gjithashtu mbështeti bashkëpunimin ndërdisiplinor dhe ndërkombëtar - në hulumtimin në terren në Rumani, për shembull, ai punoi me etnografin dhe sociologun vendas Henri H. Stahl, i cili ishte i angazhuar për kërkime në komunitetet e fshatrave dhe në Jugosllavi me etnografin Milenko Filipović, të cilin ai e ndihmoi në vitin 1952 për një praktikë hulumtimesh në Universitetin e Harvardit. Tekstet e Filipović-it u botuan më vonë në anglisht (Filipović 1982), të ngjashme me monografinë e Stahlit (1980) mbi fshatin rumun³. Mosely ishte një nga autorët më me ndikim të kohës së tij, jo vetëm për shkak të veprimtarive të tij akademike, por edhe për angazhimin e tij publik. Ai ishte gjithashtu aktiv në politikën e jashtme - siç u përmend më parë, ai ishte pjesë e një ekipi negociatorësh me Bashkimin Sovjetik në fund të Luftës së Dytë Botërore, dhe pas luftës ai u bë një nga ekspertët më të respektuar amerikanë në Europën Lindore. Gjatë periudhës së pasluftës ai promovoi gjithashtu krijimin e programeve të studimit të Bashkimit Sovjetik dhe të Europës Lindore në universitetet amerikane (Halpern dhe Kideckel 1983: 380). Ai luajti një rol të rëndësishëm në institucionalizimin e interesit të antropologëve amerikanë në Europën Lindore.

Në Universitetin Columbia në New York, Mosely bashkëpunoi me Margaret Mead dhe Ruth Benedict në Institutin e Kulturës Bashkëkohore (Institute of Contemporary Cultures), ku koncepti metodologjik i "kërkimit të kulturës në distancë" u zhvillua gjatë Luftës së Dytë Botërore për të analizuar modelet kulturore dhe "karakterin kombëtar" të shoqërive

³ Në këtë kontekst, po ashtu, mund të përmendim punën e djalit të tij Paulit (Stahl 1986), në të cilën ai është marrë me studimin krahasues/komperativ të strukturave tradicionale dhe sistemeve të pronave në Europën Jug-Lindore.

konkrete, në të cilat nuk ishte e mundur të kryheshin hulumtime klasike në terren (Mead dhe Metraux 1953). Kjo qasje u bë me urdhër të drejtpërdrejtë politik. Në këtë mënyrë, qeveria amerikane u përpoq të merrte një ide mbi vlerat kulturore, zakonet dhe idetë e shoqërive në ato vende me të cilat ishte aktualisht në luftë. Kjo metodologji përfshin intervista dhe teknika projektuese, por edhe studimin e letërsisë, filmave dhe artit. Studim prototip i kulturës në distancë është bërë analiza e kulturës japoneze nga Ruth Benedict, e porositur nga ushtria amerikane gjatë Luftës së Dytë Botërore (Benedict 1946). Në periudhën e pasluftës, Europa Lindore u bë një nga fokuset e "karakterit kombëtar", i cili ishte gjithashtu i motivuar politikisht - një numër studimesh u drejtuan për vendet që qëndronin pas Perdes së Hekurt dhe vendet që konsiderohen strategjike dhe të rëndësishme për politikën e jashtme të SHBA-së. Një nga studimet që lindi në këtë traditë ishte, për shembull, analiza e "karakterit kombëtar rumun" (Benedict 1953).

Në të njëjtën kohë me Philip Mosely, psikologjia dhe antropologjia kroate, Vera Stein Erlich kreu studimet e saj për komunitetet fshatare në Jugosllavinë e atëhershme. Me një metodë të jashtëzakonshme të dërgimit të pyetësorëve në pjesët më të largëta të Jugosllavisë, përmes dhjetëra mësuesve dhe mjekëve, u përpoq të mblidhte sa më shumë të dhëna që ishte e mundur për familjen "tradicionale". Frika nga pushtimi i afërt gjerman dhe përpjekja për të regjistruar jetën në fshat para zhdukjes së saj, luajtën një rol të rëndësishëm në këtë lloj "kërkimi shpëtimi". Në këtë mënyrë, Vera Erlich mblodhi të dhëna nga më shumë se 300 fshatra jugosllave. Ajo i kushtoi vëmendje jo vetëm temave tradicionale (*zadrugave*), por edhe marrëdhënieve personale në familje, çështjeve të lindjes, kontracepsionit ose analfabetizmit. Gjatë viteve 1952 dhe 1960 ajo punoi si pedagoge e gjuhëve sllave dhe studiuese në Universitetin Berkeley. Të dhënat e saj të para-luftës për familjet jugosllave u botuan në gjuhën serbe në vitin 1964 dhe në anglisht dy vjet më vonë (Erlich 1966).

Fillimet e "community studies" në Ballkan

Studimi i fshatit bullgar Dragalevci (tani një periferi e kryeqytetit Sofie) është realizuar gjithashtu gjatë periudhës midis luftërave nga sociologu amerikan Irwin T. Sanders (1949). Sanders erdhi në Bullgari fillimisht si mësues në kolegjin amerikan *American College* të Sofies në vitet

1929-1932 dhe, më vonë, në vitet 1934-1937. Gjatë periudhës së dytë të qëndrimit të tij në Bullgari, ai kreu kërkime në terren në Dragalevcë, duke i kushtuar vëmendje temave të tilla, si shtëpia, martesë ose bujqësia në këtë komunitet fshatar të Shopit. Ashtu si studiuesit e tjerë anglofonë, Sanders i kushton vëmendje të madhe ndryshimeve aktuale në bashkësinë lokale dhe marrëdhëniet e fshatarëve me botën më të gjerë. Ai analizon marrëdhëniet me shtetin kombëtar modern dhe mënyrat e ndryshimit të jetesës të sjellë nga industrializimi në rritje. Puna e tij prek një numër temash antropologjike ose etnologjike (endogamia, martesat e rrëmbyesve, marrëdhëniet familjare, feja etj.). Por, në disa pjesë, atij padyshim i mungon aparati i duhur konceptual. Për shembull, në fushën e administrimit të pasurisë familjare, Sanders përshkruan një sistem të sistemeve të trashëgimisë të ndarë në mënyrë të barabartë, ku djemve u jepeshin pjesë të barabarta të tokës dhe vajzat duhej të merrnin gjysmën e pjesës, shpeshherë duke hequr dorë nga pjesët e tyre në favor të vëllezërve (Sanders 1949: 54-56, 65-72). Sidoqoftë, ky përshkrim interesant i funksionimit të familjes që jetonte në një shtëpi dhe mënyrave të ndarjes së pasurisë së tij në një fshat bullgar, nuk është aspak i ngulitur në diskutimet e atëhershme të “zadrugave” (krahaso Filipović ose veprën e Mosely-t, për të mos përmendur traditën e fortë lokale etnologjike).

Një dimension interesant është dhënë nga monografia e Sanders-it për kapitujt e fundit të Dragalevcës, të shkruar pas një vizite kthimi në fshat në vitin 1945 dhe, më vonë, në vitin 1948, në të cilën autori regjistron të dy ndryshimet e sjella në fshat nga Lufta e Dytë Botërore, dhe, më në fund, reagimi i fshatarëve ndaj regjimit komunist që po vinte. Përveç Bullgarisë, Irwin Sanders ishte gjithashtu i njohur mirë me situatën e Greqisë rurale që nga fundi i viteve 1920. Në vitet 1930 ai ishte shpesh në kufirin greko-jugosllav (Agelopoulos 2013: 75). Në fund të luftës ai qëndroi në Ballkan si atashë bujqësor i ambasadës amerikane në Beograd. Gjatë viteve 1952-1953, menjëherë pas Luftës Civile Greke, ai u kthye për studime në Greqi (Sanders 1962). Për më tepër, ai botoi një numër tekstesh të vogla në periudhën e pasluftës, për shembull, në to ai merrej me marrëdhëniet e ndërsjella të grupeve nomade baritore (Karakaçanët ose Kutsovlahët) të Greqisë Veriore (Sanders 1954).

Traditat e etnografisë vendore dhe antropologjisë sociale dhe kulturore anglo-saksone nganjëherë ndërthuren, siç ishte rasti i Joseph Obrebskit, një etnografi polak, i cili fillimisht studioi etnografi sllave në Universitetin e Krakowit dhe kreu studimin e tij të parë në terren në pjesën bullgare të Dobrogeas, në Serbi dhe Maqedoni (ish Jugosllavia e atëhershme) në fund të viteve '20 dhe në fillim të viteve '30 (Obrebski 1977). Hulumtimi në terren i Obrebskit në Republikën Jugosllave të Maqedonisë, duke u përqendruar në studimet e strukturës familjare dhe shoqërore, u krye në vitet 1932-1933 në rajonin e Poreçit. Më vonë, Obrebski studioi antropologjinë sociale me B. Malinowskin në Londër, ku mbrojti doktoraturën e tij për farefisninë dhe organizimin shoqëror tek sllavët në lidhje me fenomenin e *kurade*-s, në të cilin ai përdori një pjesë të materialit të tij ballkanik (Obrebski 1977). Përveç Ballkanit, ai bëri kërkime në terren në Polesi të Europës Lindore në vitet 1930 dhe pas luftës u bashkua me një grup antropologësh britanikë në Universitetin e Londrës, të cilët kryen kërkime në Xhamajka.

